



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 16964 Prot
mbledhja nr. 12/2018

Shkodër, më 12 . 10 .2018

NJOFTIM

për thirrjen e mbledhjes së këshillit bashkiak

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të nenit 53 pika 2, pika 4; nenit 56 pika 2 shkronja "a" të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", njoftoj thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër, ditën e Premte, datë 19 Tetor 2018, ora 17:00, në sallën e mbledhjeve të këshillit bashkiak, me rend dite si më poshtë:

1. Pr/ Vendim: "Për propozim për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin Tetor 2018".
2. Pr/ Vendim: "Për dhënien e paaftësisë dhe invaliditetit të punës për muajin Tetor 2018", "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Shtator 2018", dhe "Për miratimin e kompensimit të çmimit të energjisë elektrike për kategoritë përfituese të ndihmës ekonomike, për muajin Shtator 2018".
3. Pr/ Vendim: "Për miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërave të projekteve investimeve dhe shpenzimeve korente, brenda të njëjtit program për vitin 2018".
4. Pr/ Vendim: "Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të ekonomisë pyjore/kullosore "Rosek-Rrjoll", njësia administrative Postribë, ngastra 6 dhe 7, me afat 25 vjet, për servitut kalimi për shfrytëzimin e mineralit gëlqeror të mermerizuar, bazuar në lejen minerare nr. 1835, datë 30.06.2017".
5. Paraqitja e raportit 8 mujor të vitit 2018 të monitorimit të zbatimit të buxhetit.
6. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

Grafiku i mbledhjeve të komisioneve

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al

Nr.	Komisione	Dita	Data	Ora
1	Komisioni i çështjeve ligjore	E enjte	18.10.2018	10:00
2	Komisioni i shërbimeve sociale, strehimit dhe çështjeve gjinore	E enjte	18.10.2018	11:00
3	Komisioni i arsimit	E enjte	18.10.2018	12:00
4	Komisioni i buxhetit	E enjte	18.10.2018	13:00

Duke ju falenderuar,

KRYETAR

Xhemal BUSHATI